



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.43/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave në hapësirë publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ndërkaq subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 650 (gjashtëqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 22.09.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën ankesë pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në vend, ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke e bashkëngjitur si dëshmi një fotografi të printuar nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 22.09.2017, në nënkalimin e Hekurudhave në Ferizaj, monitoruesi i tyre ka hasur në një poster të kandidatës Saranda Musliu nr. 47 për Anëtare të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik LDK, të ngjitura në hapësira publike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (Ligji Nr.03/L-073) dhe konsideron se subjekti politik LDK, ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatës për Anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj, në hapësira publike. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkëngjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, në përgjigjen në ankesë të datës 23.09.2017, ka theksuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar pasi që me asnjë dispozitë ligjore e rregullave zgjedhore 11/2013 dhe 13/2013 të KQZ-së, nuk e përcaktojnë ndalimin e vendosjes së materialeve zgjedhore në hapësirat afër nënkalimit. Për më tepër ka shtuar se nocioni “hapësirë publike” ka kuptim të gjerë, prandaj bërja e fushatës në vende publike nga ana e kandidatëve nuk është e drejtë që të interpretohet në mënyrë absolute si hapësirë publike, për çdo vendosje të posterëve me përmbajtje zgjedhore, pasi që komunat tona nuk

kanë arritur të krijojnë hapsira ekskluzive në të cilat do të vendoseshin materialet zgjedhore të kandidatëve.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoj se :

Ankesa është e bazuar

Paneli, pasi vlerësoj pretendimet e parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e supozuar, me rastin e vendosjes së posterit të kandidatës për Anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj Saranda Musliu nr.47 nga radhët e subjektit politik LDK në nënkalinimin e Hekurudhave, pra në hapsira publike, Paneli nga fotografia e administruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës, e ofruar nga parashtruesi i ankesës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterit i kandidatës për Anëtare të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik LDK, është i vendosur në vendin e palejuar, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar nuk kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që nuk kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.43/2017 më datën 25.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-